L I G J
Nr.7765, datë 2.11.1993

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.7698, DATË 15.4.1993, "PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE ISH-PRONARËVE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozim të një grupi deputetësh,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin dhe kompensimin e pronave ish-pronarëve", paragrafi i dytë i nenit 22, ndryshohet si vijon:

"Kërkesa për kalimin e pronësisë duhet të paraqitet brenda 31 marsit 1994. Në rast se personi ish-pronar, për shkaqe të përligjura, nuk ka marrë dijeni, ka të drejtë të rivendosë afatin nëpërmjet gjykatës".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekretin nr. 689, datë 10.11.1993 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.